LIGJ
Nr.10 344, datë 4.11.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE TERRORIZMIT NDËRKOMBËTAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Serbisë për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe terrorizmit ndërkombëtar".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6768, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIKUT TË PALIGJSHËM NDËRKOMBËTAR TË LËNDËVE NARKOTIKE DHE TERRORIZMIT NDËRKOMBËTAR, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Serbisë, e përfaqësuar nga Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Serbisë, këtu të ashtuquajtura si "Palët kontraktuese",

- *në përpjekje* për të kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të përbashkëta;
- *të bindur* që bashkëpunimi në fushën e luftës kundër krimit ndërkombëtar është i rëndësishëm për të dy vendet;
- *të shqetësuar* nga rreziku nga përhapja e trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope dhe format e tjera të krimit ndërkombëtar që rrezikojnë sigurinë dhe interesat e tjera vitale të të dyja vendeve;
- *duke dëshiruar* të koordinojnë aktivitetet në fushën e luftës kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe migracionit të paligjshëm, si dhe mbi bazë të:

Rezolutës së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 45/123 të 14 dhjetorit 1990, e cila i

referohet bashkëpunimit ndërkombëtar në luftë kundër krimit të organizuar, si edhe mbi bazë të Konventës së vetme mbi drogat narkotike të 30 marsit 1961, në versionin e amenduar nga Protokolli i 25 marsit 1972, si edhe në bazë të Marrëveshjes mbi substancat psikotrope të 21 shkurtit 1971, Marrëveshjes kundër trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope, të 20 dhjetorit 1988,

kanë rënë dakord sa më poshtë:

Neni 1

Fushat dhe qëllimi i bashkëpunimit

1) Në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, palët kontraktuese do të përkushtohen të bashkëpunojnë dhe të garantojnë asistencë të përbashkët zyrtare për t'u mbrojtur nga rreziqet që kërcënojnë rendin dhe sigurinë publike, si edhe për parandalimin dhe zgjidhjen e shkeljeve penale. Bashkëpunimi në veçanti do të përfshijë fushat e mëposhtme:

1. Kultivimin e paligjshëm, prodhimin, importimin, eksportimin, transportin dhe trafikimin e lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve;

2. Terrorizmin ndërkombëtar;

3. Format e tjera të krimit të organizuar ndërkombëtar, përfshirë trafikun e qenieve njerëzore migracionin e paligjshëm, bashkëpunimin në krim dhe pastrimin e parave.

2) Palët kontraktuese do të asistojnë njëra-tjetrën gjithashtu në kërkimin e personave dhe objekteve, në përputhje me legjislacionet e tyre respektive kombëtare.

Neni 2

Format e bashkëpunimit

1) Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, bashkëpunimi i palëve kontraktuese do të zhvillohet në përputhje me rregulloret ligjore kombëtare në fuqi dhe ky bashkëpunim, në mënyrë të veçantë, do të përfshijë:

1. Raportim të përbashkët mbi rrethanat dhe faktet që mund të kontribuojnë për mbrojtjen nga kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë publike; parandalimin dhe dënimin e shkeljeve penale, me kusht që të dhënat personale të mund të transmetohen vetëm në rastet kur është e nevojshme, për arsye të mbrojtjes nga kërcënimet e lartpërmendura, si edhe për të zgjidhur shkeljet penale të lartpërmendura;

2. Shkëmbim të eksperiencës mbi zbatimin e rregulloreve ligjore, mbi parandalimin e krimit dhe mbi zbatimin e metodave, mjeteve dhe veprimeve që i përkasin fushës së teknikës shkencore;

3. Shkëmbim të eksperiencës midis ekspertëve në fusha të ndryshme të kriminalitetit, si edhe në mbajtjen e takimeve për këta ekspertë;

4. Implementimi i masave të koordinuara policore të rënda dakord nga palët kontraktuese brenda territoreve të tyre respektive, me qëllim për t'u mbrojtur nga kërcënimet ndaj rendit dhe sigurisë publike, për të parandaluar kryerjen e veprimeve kriminale, si edhe për zgjidhjen me sukses të akteve penale të cilat tashmë janë kryer.

5. Garantimi i asistencës së përbashkët në luftë kundër migracionit të paligjshëm, veçanërisht në rastet që kanë lidhje me shtetasit e shteteve të palëve kontraktuese, si edhe për krijimin e kuadrit kryesor ligjor dhe organizativ për një asistencë të tillë.

2) Palët kontraktuese do të shtrijnë asistencën e ndërsjellë, në përputhje me kërkesat.

3) Secila palë kontraktuese, në përputhje me rregulloret e tyre kombëtare respektive, do t'i japin palës tjetër kontraktuese informacion nga paragrafi 1, pika 1 dhe 2 të këtij neni edhe pa kërkesë, kurdo që ka indikacione specifike për të vepruar kështu, p.sh.: në rast të njohjes së një informacioni të tillë, mund të jetë e nevojshme t'i jepet palës tjetër kontraktuese, me qëllim që të mënjanojë kërcënimin për rendin dhe sigurinë publike, ose për të parandaluar kryerjen e akteve kriminale, si edhe për të zgjidhur shkeljet penale të cilat tashmë janë kryer.

Palët kontraktuese do të shtrijnë asistencën e përbashkët, veçanërisht kur një shkelje penale

është duke u përgatitur ose është duke u kryer në territorin e njërës apo të dyja palëve kontraktuese dhe në rastet kur ekziston informacioni, i cili përcakton që në përgatitjen ose kryerjen e një shkeljeje të tillë penale, ka një lidhje me territorin e shtetit të palët tjetër kontraktuese.

Neni 3
Autoritetet kompetente

1) Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi përcaktimin e autoriteteve, të cilat, në përputhje me legjislacionin respektiv kombëtar, do të jenë kompetente për të zbatuar bashkëpunimin e përcaktuar në këtë marrëveshje. Ata janë të detyruara të informojnë njëra-tjetrën, në një afat kohor të duhur, mbi ndryshimet e mundshme mbi emrin dhe kompetencën e autoriteteve, të cilat zbatojnë bashkëpunimin e përcaktuar në këtë marrëveshje.

2) Shkëmbimi i informacionit midis palëve kontraktuese nga Organizata Ndërkombëtare Policore Kriminale-Interpol, mund të kryhet me anë të kontaktit direkt midis autoriteteve kompetente.

3) Zbatimi i bashkëpunimit midis palëve kontraktuese mund të kryhet nëpërmjet oficerëve ndërlidhës. Oficeri ndërlidhës kryhen aktivitete këshillimore dhe informuese dhe nuk ka mandat ekzekutiv. Detyrat e oficerit ndërlidhës do të përcaktohen nga autoritetet kompetente dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Neni 4
Mbrojtja e të dhënave

1) Transmetimi i përbashkët i të dhënave personale të administruara midis palëve kontraktuese, do të ekzekutohen mbi bazë të kërkesave të paraqitura, si edhe në përputhje me parimet e mëposhtme, të cilat kanë zbatim identik në procedimin automatik dhe manual të të dhënave.

1. Të dhënat e paraqitura nuk mund të përdoren për qëllime të tjera, me përjashtim të atyre arsyeve për të cilat këto të dhëna janë transmetuar, pa miratim të mëparshëm të autoritetit i cili i ka dërguar të dhënat.

2. Të dhënat e paraqitura duhet të fshihen ose të korrigjohen, në rastet kur:

a) ato dalin të jenë jokorrekte;

b) autoriteti, i cili ka dërguar ato, është informuar se të dhënat e paraqitura janë siguruar në mënyrë të paligjshme, ose të dhënat janë dërguar në kundërshtim me ligjin;

c) të dhënat nuk janë më të nevojshme për të përmbushur detyrën zyrtare për të cilën të dhënat janë paraqitur kur ishte e nevojshme, nëse nuk ka një leje të qartë për përdorimin e të dhënave për qëllime të tjera.

3. Në rast të një kërkese nga autoriteti kompetent që dërgon të dhënat te pala tjetër kontraktuese, autoriteti marrës do të informojë mbi çdo përdorim të të dhënave të marra.

2) Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën mbi të gjitha rrethanat që janë të rëndësishme për të garantuar korrektësinë dhe rifreskimin e të dhënave personale.

3) Të dy autoritet, ai që siguron të dhënat dhe ai që i merr ato, janë të detyruara të regjistrojnë në dosje/protokolle shpërndarjen, marrjen dhe fshirjen/zhdukjen e të dhënave. Regjistrat e dosjeve/protokolleve do të përmbajnë arsyet për kërkesën për të dhëna, përmbajtjen, autoritetin sigurues dhe marrës, kohën e dorëzimit të të dhënave dhe kohën e fshirjes/shkatërrimit të tyre. Transmetimi i të dhënave nëpërmjet procedurave *on line* do të regjistrohen në mënyrë automatike në dosje. Regjistrat e protokolleve do të mbahen në një periudhë kohore prej të paktën tre vjetësh. Regjistrat e protokolleve mund të përdoren vetëm për kontroll, me qëllimin që të kuptohet nëse rregulloret ligjore efektive në lidhje me ruajtjen e të dhënave janë zbatuar.

4) Me sigurimin e identitetit të tij/saj nga autoriteti përgjegjës për procedimin e të dhënave dhe me kërkesën e tij/saj, çdo person i një rasti të tillë ka të drejtën të informohet mbi të dhënat që kanë lidhje me të, të dhëna të cilat janë siguruar apo transmetuar në përputhje me këtë marrëveshje; ai/ajo gjithashtu ka të drejtën të informohet mbi origjinën e një të dhëne të tillë, qëllimin e kërkesës për përdorimin e këtyre të dhënave si mbi bazat ligjore për këtë të fundit; korrigjimin e të dhënave jokorrekte, si edhe që të dhënat personale të tij/saj që janë transmetuar në mënyrë jo të ligjshme të

fshira.

Detajet e procedurës për zbatimin e këtyre të drejtave do të harmonizohen me legjislacionin kombëtar të palës kontraktuese, nën juridiksionin e të cilit janë kryer. Për këtë arsye, palët kontraktuese, nën juridiksionin e të cilit janë kryer. Për këtë arsye, palët kontraktuese garantojnë të paktën nivelin e ruajtjes, që rrjedh nga konventa e Këshillit të Europës nr.108 për mbrojtjen e individëve në lidhje me procedimin automatik të të dhënave personale. Në rast kur kërkesa në lidhje me realizimin e këtyre të drejtave, autoriteti që i disponon të dhënat i ofron autoritetit marrës të të dhënave mundësinë për të adoptuar një qëndrim, përpara marrjes së vendimit në lidhje me kërkesën.

5) Autoriteti marrës është përgjegjës që në mënyrë të efektshme të ruajë të dhënat e transmetuara nga ndonjë shkatërrim/fshirje/humbje aksidentale/ndryshimin e paautorizuar për transmetimin e mëtejshëm të të dhënave, aksesin e paautorizuar ose shpërndarjen e paautorizuar.

6) Palët kontraktuese garantojnë që, në rast të dhunimit të së drejtës së mbrojtjes së të dhënave personale, personi në fjalë mund të apelojë në një gjykatë të pavarur ose te ndonjë autoritetit tjetër i pavarur dhe se ky person mund të realizojë të drejtën e tij/saj për ndonjë kompensim të mundshëm.

Neni 5
Konfidencialiteti

1) Të dhënat e transmetuara me qëllim realizimin e dispozitave të kësaj marrëveshje do të jenë subjekt i rregulloreve që kanë lidhje me sekretin zyrtar. Pala kontraktuese që i merr të dhënat, në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, është e detyruar të sigurojë të njëjtin nivel të sekretit dhe të mbrojtjes të këtyre të dhënave të palës kontraktuese që i ka transmetuar të dhënat.

Neni 6
Konsultimet

1) Në rast të nevojës, menaxherët e autoriteteve shtetërore të palëve kontraktuese nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, janë të autorizuar të kryejnë konsultime me qëllim diskutimin mbi mjetet dhe mënyrat për zbatimin eficent të kësaj marrëveshjeje dhe për masa të tjera për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëpunimit.

Neni 7
Rregullorja e përjashtimeve

1) Në rast se njëra nga palët kontraktuese vëren se përmbushja e një kërkese, ose që kryerja e një forme tjetër bashkëpunimi, mund të rrezikojë sovranitetin e saj, sigurinë ose interesa të tjera shtetërore, ose kjo mund të rezultojë në dhunimin e parimeve themelore të sistemit ligjor të njërës prej palëve kontraktuese, pala kontraktuese në fjalë mundet që, në mënyrë të pjesshme ose të plotë, të refuzojë këtë kërkesë, ose mund të kërkojë përmbushjen e disa kushteve të caktuara.

2) Në çdo rast individual, pala kontraktuese kërkuese duhet të informohet mbi vendimin e marrë në lidhje me kërkesën e saj.

Neni 8
Marrëdhëniet me detyrime të tjera

1) Dispozitat e kësaj marrëveshje nuk do të paragjykojnë ndonjë detyrim tjetër të ndërmarrë në lidhje me marrëveshjet ndërkombëtar të nënshkruara më parë, të lidhura tashmë nga palët kontraktuese të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9
Hyrja në fuqi dhe përfundimi

1) Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë nga dita kur palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën që kushtet e parashikuara dhe që rrjedhin nga rregulloret kombëtare ligjore të shteteve të palëve kontraktuese në lidhje me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje, janë përmbushur.

2) Palët kontraktuese lidhen në këtë marrëveshje për një periudhë të pacaktuar kohore. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe shtohet në çdo kohë, në rastet kur palët kontraktuese bien dakord për këtë paraprakisht.

3) Palët kontraktuese mund të përfundojnë këtë marrëveshje nëpërmjet kanaleve diplomatike. Përfundimi do të hyjë në fuqi pas gjashtë muajsh nga marrja e njoftimit diplomatik të dërguar nga pala tjetër kontraktuese.

Bërë më _____, më _____ në dy kopje të njëjta, në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, të gjitha tekstet të barasvlershme.

Në rast keqinterpretimi, teksti anglisht do të ketë epërsi.

LIGJ
Nr.10 345, datë 4.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË LIGJIN NR. 8093, DATË 21.3.1996 "PËR REZERVAT UJORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", të ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 61 paragrafi i dytë shkronja "a", shifra "500 000 (pesëqind mijë) lekë" zëvendësohet me shifrën "2 000 000 (dy milionë) lekë".

Neni 2

Pas nenit 71 shtohet neni 71/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 71/1

Këshilli i Ministrave miraton formularin përkatës, ku dokumentohen procedurat e zbatuara nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, sipas përcaktimeve të shkronjës "c" të nenit 61 të këtij ligji.".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6769, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi